

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E ORGANEVE TË QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ligji “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregulla për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Emërimeve, katër organeve kushtetuese garante të një qeverisjeje të drejtë, të pavarur, transparente dhe të besueshme të sistemit të drejtësisë.

Synimi i këtij ligji është mirëqeverisja e sistemit të drejtësisë në funksion të pavarësisë, përgjegjshmërisë, eficiencës dhe transparencës së tij.

Projektligji sjell një ndryshim thelbësor të rolit dhe të legjitimitetit të organit qeverisës së gjyqësorit, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i emërtuar rishtas si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), ku ndryshimet më të rëndësishme kanë të bëjnë me: (a) numrin e anëtarëve, nga 15 në 11, dhe procedurën e zgjedhjes së tyre; (b) përbërjen e organit duke ndryshuar raportin gjyqtar – jo gjyqtar dhe profilin e anëtarëve jo gjyqtarë; (c) suprimimin e tre anëtarëve *ex officio* në këtë organ (nga *Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë*); (ç) kryesimin e organit nga njëri prej anëtarëve jo gjyqtarë, duke i hequr këtë të drejtë Presidentit të Republikës; (d) suprimimin e funksionit kushtetues të Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; (dh) zgjerimin e madh të kompetencave të cilat propozohet të përfshijnë pothuaj të gjitha aspektet e administrimit të gjyqësorit; (e) kalimin nga anëtarësia me kohë të pjesshme në anëtarësi me kohë të plotë në funksion të eficiencës dhe kolegjalitetit të organit; (ë) parashikimin e një sistemi përgjegjshmërie për anëtarët; (f) marrjen e përgjegjësi për raportimin publik dhe para Kuvendit për çështje të gjyqësorit.

Gjithashtu, nëpërmjet parashikimeve në këtë ligj, ngrihet në nivel kushtetues Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe strukturimi tërësor i kompetencave të tij për emërimin, karrierën, ngritjen në detyrë dhe disiplinimin e prokurorëve.

Më tej, në zgjidhje të problematikave të lidhura me hetimin e shkeljeve disiplinore, funksioni i hetimit veçohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ndërmerret nga një organ i veçantë i zgjedhur nga Kuvendi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili është përgjegjës për verifikimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore jo vetëm ndaj gjyqtarëve, por edhe ndaj prokurorëve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, depolitizimin e procesit të emërimeve në pozicionet e larta në drejtësi, duke reduktuar diskrecionin e organeve politike të emërtesës dhe rritur cilësinë në përbërjen e institucioneve që drejtojnë sistemin e drejtësisë.

Së fundmi, ligji detajon edhe funksionimin e një organi të veçantë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili do të jetë përgjegjës për të verifikuar përmbushjen e kushteve ligjore dhe të kriterëve profesionale e morale të kandidatëve jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidatëve joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Ky ligj ka për qëllim të garantojë pavarësinë, përgjegjshmërinë, cilësinë e përbërjes, transparencën dhe eficientësinë e vendimmarrjes së organeve të rëndësishme kushtetuese dhe përmes tyre mirëqeverisjen dhe pavarësinë e gjyqësorit dhe të prokurorisë, si dhe statusin, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe paaanësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Objektivat e këtij ligji përputhen me synimin e përgjithshëm të procesit të Reformës në Drejtësi i cili është krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesionale dhe të orientuar drejt shërbimit, të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet Analizës së Sistemit të Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë identifikoi një sërë problematikash të lidhura me qeverisjen e gjyqësorit.

Konkretisht, lidhur me funksionimin e qeverisjes së sistemit të drejtësisë është vërejtur se:

- KLD ka shfaqur një frymë të dukshme korporatiste në funksionimin e tij. Shfaqjet më të dukshme të korporatizmit në punën e KLD kanë qënë promovimi i vetë anëtarëve të KLD gjatë kohës së shërbimit në këshill dhe krijimi i grupeve dhe aleancave brenda këshillit që shpesh është bërë pengesë për ndëshkimin e gjyqtarëve të caktuar. Përbërja aktuale e KLD ku 10 nga 15 anëtarët e saj vijnë nga gjyqësori krijon kushtet për korporatizëm.
- Kuadri aktual kushtetues dhe ligjor nuk parashikon asnjë kriter për përzgjedhjen e anëtarëve të KLD që emërohen nga Kuvendi si dhe asnjë mekanizëm përgjegjshmërie për anëtarët e KLD në përgjithësi. Është gjykuar se kjo gjendje ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi cilësinë e punës së KLD.
- KLD nuk është e garantuar plotësisht në pavarësinë e saj duke qënë se anëtarët e emëruar nga parlamenti votohen me shumicë të thjeshtë nga ky i fundit, duke krijuar mundësinë e ndikimit të papërshtatshëm të shumicës politike të momentit mbi anëtarët e zgjedhur prej saj.
- KLD nuk është menaxhuar në mënyrë të efektshme. Si shkaqe për këtë janë identifikuar (i) kryesimi i KLD nga Presidenti i Republikës që ka sjellë si pasojë anomali praktike në funksionimin e Këshillit dhe (ii) kompetenca e Presidentit për të propozuar Zëvendës Kryetarin e KLD, që ka sjellë si pasojë bllokimin e emërimit të Zëvendës Kryetarit për shkak të mosveprimit të Presidentit.
- Kompetencat e KLD-së për qeverisjen e pushtetit gjyqësor nuk janë të mjaftueshme për të mundësuar përfshirjen e Këshillit në hartimin e politikave dhe strategjive gjithëpërfshirëse e të qëndrueshme për qeverisjen e gjyqësorit. Disa nga përgjegjësitë më të rëndësishme në fushën e qeverisjes së gjyqësorit (p.sh. zbatimi i etikës gjyqësore, trajnimi i magistratëve, sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, mbajtja e të

dhënave statistikore dhe raportimi publik, buxhetimi, zbatimi dhe auditimi i buxhetit, planifikimi strategjik, drejtimi i administratës gjyqësore etj) nuk i janë besuar KLD-së, si organi kryesor i qeverisjes së gjyqësorit.

- Në praktikë KLD nuk ka funksionuar si një organ i vërtetë kolegjal pasi anëtarët e Këshillit (përveç Zëvendës Kryetarit) nuk shërbejnë me kohë të plotë. Kështu, anëtarët e KLD nuk marrin pjesë aktive në përgatitjen e dosjeve dhe të projekt vendimeve. Për pasojë përfshirja e tyre në punët e Këshillit reduktohet vetëm në hedhjen e votës gjatë mbledhjes plenare të KLD.
- Gjithashtu, është vënë re se mungesa e përgjegjësive (kompetencave) për çështje që lidhen me statusin e gjyqtarëve të GJL-së nuk garanton përgjegjshmërinë e këtyre të fundit dhe nuk shmanget ndikimin politik në procesin e emërimit të tyre.
- Ka një mbivendosje të spikatur të përgjegjësive midis KLD-së dhe MD-së, në lidhje me inspektimet e gjykatave, shqyrtimin e ankesave kundër gjyqtarëve dhe procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve.
- Mbetet problematike anëtarësia e Ministrit të Drejtësisë (MD) në KLD dhe e papranueshme kompetenca e tij ekskluzive për të filluar procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve.

Në lidhje me sistemin e Prokurorisë, dokumenti analitik vëren se:

- Mungojnë kriteret objektive dhe procedurat transparente në lidhje me vendimin e emërimit, karrierës, promovimit dhe disiplinimit të prokurorëve. Praktika aktuale ka treguar se vendimet lidhur me prokurorët e karrierës nuk janë udhëhequr gjithmonë nga kriteret objektive dhe procedura transparente. Vendimet e transferimit të prokurorëve nuk janë të bazuara në kriteret e mirë përcaktuara.
- Vlerësimi paraprak i punës së prokurorit kryhet nga drejtuesi i prokurorisë. Nuk ka një procedurë të standardizuar vlerësimi, të shoqëruar me kriteret specifike për matjen e aftësive, kompetencës dhe integritetit. Gjithashtu, nuk ofrohet mundësia për të ankimuar rezultatet e vlerësimit ose vendimin e emërimit.
- Emërimi i drejtuesve të prokurorisë mund të kryhet nga Prokurori i Përgjithshëm, në bazë të kriterëve të përgjithshme dhe gjithashtu shkarkimin e tyre në bazë të – mos përmbushjes së detyrave funksionale, pavarësisht rëndësisë së tyre dhe nuk parashikon mundësinë e ankimit kundër vendimit përkatës të shkarkimit.
- Ligji nuk parashikon mekanizma kontrolli dhe llogaridhënie për Prokurorin e Përgjithshëm në lidhje me veprimtarinë e tij. Gjithashtu, përbën shqetësim mungesa e llogaridhënies së Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm
- Mungojnë mekanizmat efikas të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë, për të shmangur ndërhyrjen e papërshtatshme në veprimtarinë e prokurorisë.

Bazuar në problematikat e evidentuara dhe të analizuar në Dokumentin e Analizës së Sistemit të Drejtësisë, ky projektligj parashikohet të ketë këto përparësi dhe efekte të pritshme:

- Qartëson, përmirëson, konsolidon dhe përmbledh në një ligj të vetëm (Kodifikon) dispozitat që organizojnë funksionimin e organeve kushtetuese përgjegjëse për mirëqeverisjen dhe mbikqyrjen e gjyqësorit dhe prokurorisë.

- Riformaton organin qeverisës të gjyqësorit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në përbërje dhe kompetenca si më poshtë, me qëllim që ky organ të jetë i pavarur, i paanshëm dhe transparent në vendimmarrje:
 - ndryshon emërtimin e tij, në Këshill të Lartë Gjyqësor (KLGJ)
 - ndryshon përbërjen e tij, duke hequr nga anëtarësia Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Gjykatës së Lartë dhe Ministrin e Drejtësisë, dhe shtuar në përbërje anëtarë nga shoqëria civile, sfera akademike dhe profesionet e lira në raportin 6 (anëtarë gjyqtarë) me 5 (anëtarë jogjyqtarë), me qëllim rritjen e cilësinë, paanshmërinë në vendimmarrje dhe besimit e qytetarëve në administrimin e drejtësisë.
 - garanton përgjegjshmërinë në vetëorganizimin e KLGJ-së duke përcaktuar se Kryetari i KLGJ zgjidhet nga vetë Këshilli, nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë.
 - rrit përgjegjësinë e KLGJ-së për të gjitha çështjet që lidhen me statusin e gjyqtarëve, jo vetëm për vlerësimin e veprimtarisë profesionale dhe etike, ngritjen në detyrë, transferimin dhe disiplinimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, por edhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.
 - përcakton se KLGJ i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë
 - bazuar në analizën e ngarkesës së çështjeve gjyqësore në gjykata, dhe në të dhënat mbi çështje të aksesit në drejtësi, pas konsultimit me kryetarët e gjykatave dhe Ministrin e Drejtësisë, Këshilli përcakton numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve, numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë si dhe numrin e gjykatave, vendndodhjen dhe kompetencën e tyre territoriale pas një studimi vlerësues.
 - ngarkon me përgjegjësi të reja KLGJ-në, më konkretisht, për administrimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, mbajtjen e sistemit statistikor të gjyqësorit, marrëdhëniet e gjyqësorit me publikun dhe mediat, menaxhimin e administratës gjyqësore, raportimin para publikut dhe Kuvendit, administrimin e infrastrukturës fizike dhe të sigurisë, si dhe matjen e performancës së gjykatave, përgjegjësi të cilat aktualisht i ka Ministria e Drejtësisë.
 - ngarkon me përgjegjësi KLGJ-në për miratimin e rregullave të etikës gjyqësore dhe mbikëqyrjen e respektimit të tyre. KLGJ siguron mbështetjen e nevojshme me burime njerëzore dhe financiare për të mundësuar veprimtarinë e një Këshilltari për Etikën me mandat 5 vjeçar.
 - për një qasje më gjithëpërfshirëse në zhvillimin e politikave të sektorit buxhetor dhe shmangjen e ndikimit të ekzekutivit në kontrollin e buxhetit, ngarkon me përgjegjësi KLGJ-në për planifikimin strategjik për gjyqësorin dhe buxhetin gjyqësor, duke lejuar pjesëmarrjen pa të drejtë vote të Ministrit të Drejtësisë në mbledhjet ku diskutohet plani strategjik dhe politikat e sektorit buxhetor të gjyqësorit.
 - heq nga KLGJ kompetencat për hetimin e shkeljeve disiplinore, të ankesave kundër gjyqtarëve si dhe atë të inspektimit të gjykatave. Këto kompetenca i kalojnë një organ i ri, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
 - organizon punën e KLGJ-së nëpërmjet komisioneve të përhershme, dhe kur është e nevojshme për çështje të veçanta edhe të përkohshme, të cilat përgatisin projekt vendime në fushat përkatëse dhe i propozojnë Mbledhjes të Këshillit, miratimin e tyre.

- Ngarkon me përgjegjësi KLGJ-në për të shprehur mendime dhe konsiderata lidhur me ndryshimet eventuale në legjislacionin që ndikon në çështjet të cilat janë nën përgjegjësinë e Këshillit.
- Rikoncepton Këshillin e Lartë të Prokurorisë si një organ të pavarur kushtetues me kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa më poshtë:
 - Shqyrton dhe merr vendime lidhur me statusin e prokurorëve si ato për rekrutimin, emërimin, transferimin, riemërimin dhe disiplinimin e tyre.
 - I propozon Kuvendit kandidatin për Prokuror të Përgjithshëm.
 - Ndan pushtetin e Prokurorit të Përgjithshëm me KLP me qëllim për të ndikuar në rritjen e pavarësisë së brendshme të prokurorëve në raport me prokurorët më të lartë dhe të pavarësisë së jashtme të institucionit.
- Siguron eficiencën dhe respektimin e kolegjalitetit të organeve qeverisëse të KLGJ-së dhe KLP-së, duke shmangur konfliktet e mundshme të interesit, si dhe garanton përgjegjshmërinë e anëtarëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke përcaktuar se anëtarët i kryejnë funksionet e tyre me kohë të plotë.
- Garanton një proces transparent, përfaqësues, gjithëpërfshirës dhe të drejtë për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të organeve qeverisëse të gjyqësorit dhe prokurorisë, përkatësisht të Këshilli I Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me qëllim garantimin e një sistemi funksional dhe të pavarur drejtësie.
 - Përcakton në ligj kritere të qarta që duhet të përmbushin anëtarët e KLD-së, me qëllim garantimin e cilësisë, profesionalizmit, integritetit të lartë moral e profesional të tyre;
 - Për anëtarët gjyqtarë dhe prokurorë, përzgjedhja bëhet nga rradhët e gjyqësorit/prokurorisë nëpërmjet kandidaturave proporcionale sipas të tri niveleve (tre kandidatë nga shkalla e parë, dy nga apeli dhe një nga Gjykata e Lartë).
 - Garanton një proces transparent për verifikimin dhe shpalljen e kandidaturave nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Këshilli, si dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimeve për përjashtimin e kandidaturave.
 - Siguron një proces transparent votimi të kandidaturave nga gjyqësori/prokuroria duke e hapur ndaj medias, si dhe një administrim efektiv të procesit nëpërmjet një komisioni të posaçëm me detyra të mirëpërcaktuara.
 - përcakton kritere të qarta për kandidatët jo-gjyqtarë për anëtarë të Këshillave, duke parashikuar një organ të veçantë, Këshillin e Emërimeve, për verifikimin e kushteve ligjore e morale dhe renditjen e kandidatëve sipas kritereve të meritës dhe kualifikimit
 - Kujdeset për një zgjedhje përfaqësuese të kandidaturave që vijnë me votim nga dhomat e avokatisë, dhomat e noterisë, trupa e pedagogëve të drejtësisë, trupa e pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës dhe shoqëria civile.
- Kujdeset për statusin e anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së pas përfundimit të mandatit të tyre, duke i kthyer ata në pozicionet e mëparshme.
- Eviton mbivendosjen e përgjegjësive për inspektimin e gjykatave dhe shqyrtimin e ankesave kundër gjyqtarëve mes Këshillit dhe Ministrisë së Drejtësisë duke veçuar organin e inspektimit.
- Garanton ndarjen e procesit të inspektimit nga procesi vendimmarrës për dhënien e masës disiplinore. Për kryerjen e inspektimit parashikohen dispozita të veçanta për funksionimin

e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si autoriteti shtetëror përgjegjës për hetimin e shkeljeve dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin e gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

- Zgjidh problematikën e kompetencës ekskluzive të Ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve duke ja lënë këtë kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe duke i rezervuar edhe Ministrit të drejtën t'i kërkojë Inspektorit fillimin e hetimit ndaj një apo më shumë gjyqtarëve të veçantë në lidhje me akuza për shkelje disiplinore.
- Ndhmon në depolitizimin e procesit të emërimit, garantimit të cilësisë profesionale dhe integritetit të Inspektorit, duke përcaktuar se Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, midis kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita.
- Për ushtrimin e funksioneve hetimore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndihmon me krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e përbërë nga Inspektorët e Drejtësisë dhe nga administrata. Garanton një procedurë transparente dhe të drejtë për emërimin e inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë, të bazuar në kritere të qarta dhe objektive.
- Për një sistem llogaridhënie në të gjitha nivelet, procedimet disiplinore të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj gjyqtarëve shqyrtohen dhe vendosen nga KLGJ-ja. Procedimet disiplinore të filluara nga Inspektori ndaj prokurorëve shqyrtohen dhe vendosen nga KLP-ja dhe procedimet disiplinore ndaj anëtarëve të këtyre dy këshillave (KLGJ dhe KLP) si dhe ndaj Prokurorit të Përgjithshëm shqyrtohen dhe vendosen nga Gjykata Kushtetuese. Gjithashtu, hetimi për mbledhjen e provave dhe fakteve që vërtetojnë shkeljet e rënda të Inspektorit, kryhet nga një komision hetimor parlamentar ndërkohë që vendimi merret nga Gjykata Kushtetuese.
- Kujdeset për depolitizimin e procesit të emërimeve në pozicionet e larta në drejtësi, nëpërmjet dispozitave që rregullojnë funksionimin e Këshillit të Emërimeve, duke reduktuar diskrecionin e organeve politike të emërtesës dhe rrit cilësinë në përbërjen e institucioneve që drejtojnë sistemin e drejtësisë.
- Shmang korporatizimin dhe ndikimin e papërshtatshëm në emërimin e funksionarëve të drejtësisë duke parashikuar një përbërje të Këshillit të Emërimeve me short, mes gjyqtarëve dhe prokurorë të niveleve të ndryshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet kushtetuese të miratuara nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë me Projektligjin për amendimet kushtetuese të datës 14.06.2016“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998 ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”, si dhe me ligjet në fuqi.

Gjatë hartimit të këtij ligji janë marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe praktikat ligjore më të mira të vendeve me demokraci të konsoliduar. Në mënyrë të veçantë, për hartimin e dispozitave janë mbajtur parasysh konventat ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, aktet udhëzuese ndërkombëtare si Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, Parimet Bazë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit, Parimet e Bangalorit për Sjelljen e Gjyqtarëve, *Magna Carta* e Gjyqtarëve, 2010 dhe Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, Opinioni 1 (2001). Është treguar kujdes që këto standarde dhe praktika të përshtaten me kontekstin e zhvillimeve dhe dinamikave të vendit tonë, me synimin që dispozitat e këtij ligji të jenë të zbatueshme.

Dispozitat e këtij ligji gjejnë mbështetje në raportet dhe opinionet e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (*Komisioni i Venecias*) për emërimet në gjyqësor, për përbërjen e Këshillave Kombëtare Gjyqësore, në lidhje me gjykatat dhe gjyqtarët. Gjithashtu, ato janë në përputhje të plotë me Opinionin e Ndërmjetëm (*18-19 Dhjetor 2015*) dhe Opinionin Përfundimtar të Komisionit të Venecias për Projekt Ndryshimet Kushtetuese për Sistemin Gjyqësor në *Shqipëri (15 janar 2016)*.

Në mënyrë specifike, standarteve ndërkombëtare ju është referuar për çështjet si më poshtë:

Në lidhje me përbërjen e këshillave për gjyqësorin:

- Anëtarët e organit gjyqësor vetëqeverisës nuk janë përfaqësues të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ¹, janë të paktën 50% gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, dhe për pjesën tjetër anëtarë jogjyqtarë²;
- edhe "përdoruesit e sistemit gjyqësor" (avokatë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe akademike) duhet të kenë një vend³
- Kryetari i Këshillit Gjyqësor duhet të zgjidhet nga Këshilli Gjyqësor nga nga rradhët e anëtarëve tij jo gjyqtarë...⁴
- Një dispozitë për një panel më të vogël disiplinor brenda Këshillit Gjyqësor me një barazi të anëtarëve gjyqësore dhe jo gjyqësorë. .⁵
- Disa vende nuk zgjedhin të lejojnë kryetarin e Gjykatës së Lartë që të jetë kryetar i Këshillit. Në funksion të rritjes së pavarësisë gjyqësorit, të tjerë mund të preferojnë që kryetari i gjykatës të emërohet kryetar i Këshillit, por pastaj të japë dorëheqjen nga pozicioni në Gjykatës së Lartë. .⁶

Për zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillave për Gjyqësorin

- Anëtarët të cilët nuk janë përfaqësues të gjyqësorit duhet mundësisht të emërohen nga dega e legjislativit.⁷
- Anëtarët jo gjyqtarë duhet të zgjidhen nga Parlamenti dhe jo nga Presidenti i Republikës.⁸

¹ Në Opinionin Nr 10/2007 KKGJE rekomandon, se "anëtarët e ardhshëm të Këshillit për Gjyqësorin, qoftë gjyqtarë apo jo-gjyqtarë, nuk duhet të jenë politikanë aktive, anëtarë të parlamentit, ekzekutiv apo administratës. Kjo do të thotë se as kreu i shtetit, nëse ai / ajo është kreu i qeverisë, as ndonjë ministër nuk mund të jetë një anëtar i Këshillit për Gjyqësorin." Shih edhe rekomandimet e Kievit, f. 4.

² Në Opinionin Nr. 677/2012 Komisioni i Venecias (në lidhje me Ligjin për Këshillin Gjyqësor në Mal të Zi), përhëndeti barazinë ndërmjet anëtarëve të gjyqësorit dhe jo gjyqësorit në Këshillin e Gjyqësorit dhe zgjedhja e Presidentit nga rradhët e anëtarëve të Këshillit të Gjyqësorit të cilët nuk kryejnë funksione gjyqësore .

³ Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias në lidhje me Gjykatat dhe Gjyqtarët, pika 4.2.2, fq 77.

⁴ Po aty, pika 4.2.4, fq 79.

⁵ Po aty., pika 4.2.4, fq. 79.

⁶ Po aty., para 4.2.6, p 82

⁷ Po aty., 4.3., fq. 85.

⁸ Po aty, pika 4.3, fq. 85.

- Delegacioni përsëriti propozimin e Komisionit për ta pasur komponentin Parlamentare të Këshillit të zgjedhur me shumicë të cilësuar.⁹
- Një shumicë prej 2/3 ose 3/4 për zgjedhjen e anëtarëve nga parlamenti, një tjetër për të siguruar që një nga dy anëtarët jo gjyqtarë duhet të caktohet nga opozita parlamentare ...¹⁰

Për qëndrimin në detyrë të anëtarëve të këshillave për gjyqësorin

- Anëtarët e zgjedhur do të përfundojnë mandatin e tyre në të njëjtën kohë¹¹ ...
- Një mandat prej 3 vitesh konsiderohet shumë i shkurtër.¹²
- Një mandat prej 6 vitesh konsiderohet i përshtatshëm.¹³

Mbi përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të këshillave për gjyqësorin

- Vendimet për pezullimin e një anëtari duhet të lidhen me peshën e akuzave kundër tij/saj ...¹⁴
- Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të iniciojë shkarkimin e çdo anëtari tjetër.¹⁵
- Ligji duket se do të thotë se një person mund të hiqet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë për sjellje të pamoralshme...¹⁶
- Statusi i Anëtarësimit mund të pezullohet edhe kur statusi i anëtarit si gjyqtar ose prokuror pezullohet për shkak të një hetimi penal që po kryhet apo për arsye të tjera sipas ligjit.¹⁷
- Një procedurë disiplinore mund të zbatohet vetëm në rastet e shkeljeve disiplinore dhe jo për shkak të mungesës së besimit ..¹⁸

Mbi kriteret për t'u zgjedhur si anëtar i një këshilli për gjyqësorin

- Është me rëndësi jetike që anëtarët e Këshillit të kenë përvojë të mjaftueshme praktike prej shtatë vitesh...¹⁹ Kërkesa e 10 viteve përvojë duhet të rivlerësohet.²⁰
- Anëtarët e Këshillave nuk duhet të jenë kryetarët të gjykatave.²¹

Për zgjedhjen e kryetarit të këshillave për gjyqësorin

- Zgjedhja e kryetarit të Bordit nga ana e anëtarëve të tij me votim të fshehtë ... është për t'u përhëndetur. Megjithatë do të ishte e dëshirueshme që Bordi të zgjedhë një Zëvendëskryetar për të vepruar në mungesë të kryetarit²²

Mbi kompetencat e këshillave për gjyqësorin

- Opinioni Nr.10 (2007) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) thekson se përtej rolit të tij menaxhues administrativ kundrejt gjyqësorit, Këshilli për Gjyqësorin duhet edhe të mishërojë qeverisjen autonome të pushtetit gjyqësor ...
- Gjyqësori duhet të luajë një rol të madh në ose në vetvete të jetë përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit ...²³

⁹ Po aty, pika 4.3, fq 90, pika 4.3, fq 85.

¹⁰ Po aty, pika 4.3, fq. 85.

¹¹ Po aty, pika 4.3, fq 89.

¹² Po aty, pika 4.3, fq 89.

¹³ Po aty, pika 4.3, fq 89..

¹⁴ Po aty, pika 4.3, fq 90.

¹⁵ Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias në lidhje me Gjykatat dhe Gjyqtarët, pika 4.3, fq 90.

¹⁶ Po aty, pika 4.3, fq 90.

¹⁷ Po aty, pika 4.3, fq 90.

¹⁸ Po aty, pika 4.3, fq 91/92.

¹⁹ Po aty, pika 4.2.4, fq 80.

²⁰ Po aty, pika 4.2.4, fq 80.

²¹ Rekomandimet e Kiev mbi Pavarësinë e Gjyqësorit në Europën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, para 7, fq 3

²² Compilation of Venice Commission Opinions and Reports Concerning Courts and Judges, para 4.2.6, p 83.

²³ Opinion no 4 of the Consultative Council of European Judges (CCJE) on appropriate initial and in-service training for judges at national and European levels , para 16/17.

- (Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë) ka kompetenca të gjera ...: ai emëron gjyqtarë dhe prokurorë, vendos për pezullimin ..., përcakton kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, vendos për apelimet në procedurë disiplinore²⁴
- Detyrimi i Këshillit për të ofruar një raport vjetor tek Asambleja Kombëtare duket i arsyeshëm.²⁵

Në lidhje me funksionin e inspektimit

- Nuk është e pazakontë në Evropë që të ketë një farë organi inspektues që mbikëqyr gjyqtarët ... për të parë nëse ata kryejnë detyrat e tyre në mënyrë korrekte .²⁶
- Shërbimi i inspektimit duhet të jetë i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe nga organi që vendos për vendosjen e sanksioneve disiplinore.²⁷ Inspektorët nuk duhet të jenë vlerësues²⁸.

Në ligj përcaktohen qartë parimet të cilat duhet ta udhëheqin sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Sistemi i drejtësisë duhet të jetë i pavarur ndaj çdo lloj ndikimi, i paanshëm në funksionimin e tij, i përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore të tij, eficient dhe profesional, i besueshëm, transparent dhe i aksesueshëm prej publikut, si dhe bashkëpunues në nivel institucional kur ushtrohet pushteti vendimmarrës për emërimin e funksionarëve të lartë të sistemit.

Në ligj përcaktohet qartë se Këshilli i Lartë Gjyqësor i ushtron funksionet e tij sipas Kushtetutës, këtij ligji dhe ligjeve të tjera, si dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme, për të garantuar pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit, respektimin e parimeve që udhëheqin statusin e gjyqtarëve si dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Njëkohësisht, në ligj renditen edhe parimet që udhëheqin procedurat e hetimit të shkeljeve disiplinore të tilla si ligjshmëria, pjesëmarrja e subjektit të kontrolluar në procedurë, nëpërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të pretendimeve të tij, formalizimi i procedurave, ndalimi i ribërjes së një procedure të trajtuar më parë, prezumimit të pafajësisë, tipizimi i shkeljes, trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim, profesionalizmi dhe objektiviteti, si dhe konfidencialiteti i të dhënave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka përafrim me *acquis communautaire*.

²⁴ Compilation of Venice Commission Opinions and Reports Concerning Courts and Judges, para 3.3, p 73.

²⁵ Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias në lidhje me Gjykatat dhe Gjyqtarët, para 3.3, p 74.

²⁶ Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias në lidhje me Gjykatat dhe Gjyqtarët pika 3.3, fq. 72.

²⁷ Në Opinioni Nr. 770/2014 Komisioni i Venecias dhe OSBE / OHDIR duke iu referuar një projekt-amendamenti për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve në Republikën Kyrgizistanit thuhet se "e mirëpresim faktin se projekt-ndryshimet në Ligjin Kushtetues të prezantojnë ... një ndarje të qartë të detyrave ndërmjet organit përgjegjës për hetimin (Komisionit Disiplinor) dhe organit përgjegjës për marrjen e vendimeve për vendosjen e sanksionit disiplinor, përkatësisht Këshillit të Gjyqtarëve. Kjo është në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare të cilat sugjerojnë krijimin e një organi të pavarur për fillimin e procedurës disiplinore, i cili është i ndarë nga organi apo gjykata e pavarur që do të marrë vendimin në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit".

²⁸ Në Opinioni Nr. 751/2013 të Komisionit të Venecias në lidhje me sistemin e vlerësimit në Armeni, ku ligji parashikon që një Komision i Etikës dhe Disiplinës në Këshillin e Gjyqtarëve organizon dhe zhvillon hetimin në procedimet disiplinore dhe si bën vlerësim gjithashtu, verën se fuqizimi i një Komisioni të (etikës dhe) Disiplinës me detyrën e kryerjes së vlerësimeve ... na çon në përfundimin se këto do të përdoren kryesisht për qëllime disiplinore. Kjo për rrjedhojë mund të mos jetë një zgjidhje e mirë dhe mund të çojë sinjalin e gabuar

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë” përbëhet nga 6 pjesë (tituj), të ndarë në krerë, seksione, dhe nënseksione ku janë shpërndarë 193 nene.

Në mënyrë më të detajuar, në **Pjesën I (ose Titullin I)**, parashikohen Dispozitat e Përgjithshme të projektligjit, ku përcaktohet objekti i ligjit dhe parimet në bazë të cilave funksionon sistemi i drejtësisë.

Pjesa II (Titulli II) rregullon përbërjen dhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në mënyrë më specifike, **Kreu I, Seksioni 1** përmban dispozita për përbërjen e Këshillit, mandatin e anëtarëve, statusin dhe përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të tij.

Kreu I, Seksioni 2 rregullon mënyrën e zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. **Nënseksioni 1** parashikon procedurën e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë suke përcaktuar kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që vijnë nga gjyqësori, procedurën e paraqitjes dhe shqyrtimit të kandidaturave, duke nisur me pritjen e kandidaturave sipas nivelit të gjykatave (tri kandidatë nga shkalla e parë, dy nga apeli dhe një nga Gjykata e Lartë). Dispozitat parashikojnë thirrjen për interes për kandidime, verifikimin dhe shpalljen e kandidaturave nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimeve për përjashtimin e kandidaturave, procedurën e votimit të anëtarëve.

Nënseksioni 2 përmban rregulla për procedurën e zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga avokatia, duke nisur me kriteret ligjore të kandidatëve, verifikimin e kushteve ligjore e morale dhe renditjen e kandidatëve sipas kriterëve të meritës dhe kualifikimit, procedura e thirrjes për kandidatura, verifikimi i plotësimit të kushteve, ankimi, procedura e votimit dhe shpallja e rezultatit si dhe vendimmarrja nga Kuvendi i RSH-së.

Nënseksioni 3, përcakton procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga noteria të ngjashme me rregullat e parashikuara për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve nga avokatia, duke nisur me kriteret ligjore të kandidatëve, verifikimin e kushteve ligjore e morale dhe renditjen e kandidatëve sipas kriterëve të meritës dhe kualifikimit, procedura e thirrjes për kandidatura, verifikimi i plotësimit të kushteve, ankimi, procedura e votimit dhe shpallja e rezultatit si dhe vendimmarrja nga Kuvendi i RSH-së.

Në mënyrë të ngjashme, në **Nënseksionin 4** detajohet procedura e zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga trupa e pedagogëve të drejtësisë, ndërsa në **Nënseksionin 5** ajo e anëtarëve nga trupa e pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës. Më tej, **Nënseksioni 6** rregullon procedurën e zgjedhjes së anëtarit që përfaqëson shoqërinë civile.

Kreu II, Seksioni 1, përcakton rregulla për mënyrën e organizimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, kompetencat e Kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit të lartë gjyqësor, kompetencat e Mbledhjes së KLGJ-së, përcaktimi i rregullave të funksionimit të Komisioneve të përherëshme. Pesë komisione e përherëshme si Komisioni i Planifikimit Strategjik; Komisioni i Administrimit dhe Buxhetit; Komisioni Disiplinor; Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Gjyqësore dhe Etike; Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Në këtë seksion ligji lejon edhe ngritjen e komisioneve të përkohshme për çështje të vaçanta.

Seksioni 2 i këtij Kreu trajton organizimin e administratës mbështetëse të Këshillit ndërsa **Seksioni 3** përcakton rregullat për thirrjen, zhvillimin dhe procedurën e ndjekur gjatë mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kuorumin e nevojshëm dhe vendimmarrjen e e Këshillit.

Kreu III, përmbledh funksionet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë duke nisur me planifikimin strategjik, raportimin publik dhe para Kuvendit, kujdesi për respektimin e etikës gjyqësore, dhe duke vazhduar me përcaktimin e numrit të gjyqtarëve dhe gjykatave, rekrutimin, emërimin dhe propozimi i gjyqtarëve, si dhe mbikqyrjen e gjyqtarëve (duke shqyrtuar dhe marrë vendime për vlerësimin e veprimtarisë profesionale dhe etike, ngritjen në detyrë, transferimin dhe disiplinimin). Këshilli është gjithashtu përgjegjës për trajnimin gjyqësor, administrimin e gjykatave dhe burimet njerëzore në to, buxhetin e tyre, sistemin e menaxhimit të çështjeve, qasjen në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun, teknologjinë e informacionit, buxhetin vjetor të Këshillit,

Dispozitat e **Kreut IV** të këtij ligji përcaktojnë aktet dhe rregullat procedurale të zbatuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë procesit të shqyrtimit të çështjeve dhe vendimmarrjes së tij.

Pjesa II (Titulli II) i Projektligjit përmban dispozita për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të cilat referojnë te zbatimin, për aq sa është e mundur, të dispozitave për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Gjyqësor.

Pjesa III (Titulli III) rregullon organizimin dhe funksionimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si autoritet përgjegjës për hetimin e shkeljeve dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Kreu I i Projektligjit parashikon dispozita për organizimin e organit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke nisur me parimet dhe procedurat, objektin e veprimtarisë së Inspektorit të lartë të Drejtësisë, parimet themelore të veprimtarisë dhe organizimit, buxhetin dhe strukturën.

Kreu II, i projektligjit parashikon përzgjedhjen dhe emërimin e Inspektorit të Lartë, kushtet dhe kriteret e emërimit, papajtueshmëritë, qëndrimi në detyrë, inspektimi dhe përgjegjësia disiplinore, kompetencat, mandatin, kompetencat e zëvendës Inspektorit, etj.

Kreu III, parashikon kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për zgjedhjen dhe kryerjen e detyrës të Inspektorit në Inspektorit të Lartë të drejtësisë, statusi dhe emërimi i inspektorëve, vlerësimi i performancës, shkeljet disiplinore dhe përbërja e administratës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pjesa IV (Titulli IV), **Kreu I** përmban rregulla për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, për funksionin dhe përgjegjësitë. **Kreu II** parashikon rregulla për përbërjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, përbërja, mandati i anëtarëve, zëvendësimi i tyre, kushtet e përzgjedhjes së tyre, organizimi i shortit, etj.

Kreu III përmban dispozita për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke përfshirë funksionin e Kryetarit, zëvendëskryetarit, mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë dhe vendimmarrjes, personelit administrativ, sistemin e menaxhimit të çështjeve, transparencën, etj.

Kreu IV, përmban dispozita për verifikimin e kushteve ligjore dhe renditjen e kandidatave, subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve, deklarimi dhe kontrolli i pasurisë dhe

rekordeve penale të kandidatëve, kriteret profesionale dhe morale për renditjen e kandidatëve, aktet e verifikimit, etj.

Në **Seksionin 4**, parashikohen dispozita për përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve, zhvillimin i procedimit disiplinor ndaj anëtarëve dhe shqyrtimin e çështjeve.

Titulli VI përmban dispozitat e fundit dhe kalimtare e projektligjit ku parashikohet kryerja e funksioneve deri në konstituimin e institucioneve të parashikuara në Projektligjin për Ndryshimet Kushtetuese përkatësisht (1) Këshillin e Lartë Gjyqësor, (2) Këshillin e Lartë të Prokurorisë, (3) Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë dhe (4) Këshillin e Emërimeve.

Në **Kreun I**, parashikohet zgjedhja e anëtarëve të KLGJ-së, krijimin dhe ngritjen e strukturës organizative të KLGJ-së. Në **kreun II**, parashikohet zgjedhja e anëtarëve të KLP-së, krijimin dhe ngritjen e strukturës organizative të KLP-së, në **kreun III**, parashikohet zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe krijimi i zyrës së tij, dhe në **Kreun IV**, parashikohet krijimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen me përgjegjësitë kryesore për zbatimin e këtij projektligji janë Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve. Gjithashtu, ky projektligj, në kapituj dhe pjesë të veçanta të tij parashikon detyra dhe përgjegjësi për institucione të tjera si Dhomat e Avokatisë, Dhomat e Noterisë, Trupat e Pedagogëve dhe Rektoratet, Shkolla e Magjistraturës, etj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Grupi i punës i ngarkuar për hartimin e këtij projektligji është ngritur në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, pjesë e Shtyllës për Pushtetin Gjyqësor. Në përbërje të këtij grupi pune kanë qenë ekspertë të nivelit të lartë, përfaqësues të Misionit Euralius IV, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Grupi i punës është asistuar nga Sekretariati Teknik, i përbërë nga juristë dhe përfaqësues të Kuvendit, Gjykata e Lartë, Ministria së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Misionit Euralius, Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe juristë të fushës.

Projektligji është hartuar gjatë periudhës nëntor 2015 – Prill 2016 dhe ka qenë një dokument që është konsultuar me përfaqësues të rrjetit të konsultimit Think Tank, përbërë nga ekspertë të opozitës parlamentare, Ministrisë së Drejtësisë, Gjyqtarë, Prokurorë, Avokatë, Pedagogë, etj. Përveç diskutimeve në të grupit hartues, është parë e nevojshme mbledhja e informacioneve shtesë. Për këtë është bërë kërkim në legjislacion dhe marrje të dhënash nga institucione. P.sh., në kuadër të punës për hartimin e dispozitave për Këshillin e Lartë Gjyqësor janë kryer takime me ZABGJ-në si dhe është kërkuar e marrë informacion me shkrim nga anëtarët e Bordit të ZABGJ-së mbi problematikat e funksionimit të ZABGJ-së dhe sugjerimet për zgjidhjen e tyre.

Projektligji së bashku me dy projektligjet e tjera të grupit të gjyqësorit, gjatë periudhës Maj – Qershor është konsultuar publikisht dhe është rishikuar disa herë nën dritën e komenteve dhe sugjerimeve të aktorëve të sistemit të drejtësisë. Gjatë muaji maj 2016, ky projektligj së bashku me dy projektligjet e tjera të shtyllës së gjyqësorit, kaluan në proces konsultimi me aktorë të sistemit të drejtësisë, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në sistem dhe krerët e gjykatave dhe prokurorive, përfaqësues të institucioneve shtetërore si Ministria e Drejtësisë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile aktive në fushën e drejtësisë. Procesi i parë i konsultimit u zhvillua në Tiranë, datë 11 Maj 2016, ku morën pjesë rreth 90 pjesëmarrës të cilët dhanë komentet e tyre. Procesi i dytë i konsultimit u zhvillua në Vlorë, datë 16 maj 2016, ku u ftuan kryesisht gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave të zonës së jugut të Shqipërisë, në të cilën morën pjesë rreth 50 pjesëmarrës, të cilët dhanë komentet e tyre. Komentet e marra nga të gjithë pjesëmarrësit u shqyrtuan në mbledhjet e grupit hartues dhe janë reflektuar në tekstin e projektligjit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE